

P. nr.77/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Bute Ramosaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. V. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të lëndim i lehte trupor nga neni 188/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.1489/2017 të datës 26.01.2018, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **30.08.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj, si dhe të akuzuarit S. V., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S. V.** nga Gjakova ;Rr” “....” Lagjja K, ne Gjakovë, i biri S. dhe i nënës A. e gjinisë A., lindur me dt. 14.01.1986 ne Gjakove, analfabet, i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike - rast social, Egjiptian ,shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 5 fëmijëve, me ID

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-me dt.18.09.2017, rreth orës 22.30, në Gjakovë ,Rr. “....”, në lagjen K., i shkakton lëndime te lehta trupore personit tjetër të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë, qe pas një mosmarrëveshje ndërmjet të akuzuarit ... dhe të dëmtuarit – të miturit F.S. ku i akuzuari e godet të dëmtuarin me një shkop bejsbolli në kokë me ç ‘rast të njëjtit i shkakton lëndime të lehta trupore.

me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-1.4 te KPRK-së

Andaj gjykata në bazë te nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës, dhe nenit 188/1 te KPRK-ës dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim me kohëzgjatje prej **90(nëntë dhjet) ditëve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore te Gjykatës .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP//nr.1489/2017 të datës 26.01.2018, e ka akuzuar të akuzuarin S. V. nga Gjakova, për shkak se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1 të KPRK-së.

Prokurori shtetit Armend Zenelaj, në shqyrtimin fillestar lexon aktakuzën PP/II.nr.1489/17 dt.26.01.2018,me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës ,por benë përmirësimin

lidhur me kualifikimin juridik te kësaj vepre penale ku kualifikimit juridik nga neni 188 par. 1 te KPRK-se, i shtohet nen par 1.4 i këtij neni, meqenëse kemi te beje me lëndim te lehta trupore me dëmtime te perkohshëm te shëndetit, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari S. V. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, kërkojë falje nga i dëmtuari për lëndimin e shkaktuar , mirëpo te njëjtin e kam kryer ne afekt mirëpo siç kam deklaruar edhe ne polici kam qene i provokuar dhe njëkohësisht i sulmuar nga këtu i dëmtuari F. S., ku njëkohësisht kam pësuar lëndime unë dhe djali im A. V. i moshës 11 vjeçar, e të cilën vepër e kam kryer ne afekt, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, më te dëmtuarin asnjëherë me pare unë personalisht nuk kam pasur probleme, andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike andaj i propozoi Gjykatës qe te me shqiptoi një dënim sa me te bute.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori Armend Zenelaj , ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova te mjaftueshme andaj i propozoj gjykatës se i akuzuari S. V. te shpallet fajtor, te dënohet sipas ligjit dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari S. V. : me dt.18.09.2017, rreth orës 22.30 ,në Gjakovë ,Rr. "...", në lagjen K. , i shkakton lëndime te lehta trupore personit tjetër të cilat rezultojnë me dëmtim të perkohshëm të shëndetit , në atë mënyrë , qe pas një mosmarrëveshje ndërmjet të akuzuarit ... dhe të dëmtuarit – të miturit F.S. ku i akuzuari e godet të dëmtuarin me një shkop bejsbolli në kokë me ç ‘rast të njëjtit i shkakton lëndime të lehta trupore.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimi te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se është baba i 5 fëmijëve dhe mbajtës i vetëm i familjes prej 7 anëtarësh , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte në gjykim, pendimin e tij të shprehur në gjykate për veprën e kryer në afekt , premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe do të jetë më i kujdesshëm , kërkim falja nga i dëmtuari për lëndimin e shkaktuar, gjendja e varfër ekonomike shfrytëzues i ndihmave sociale .

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit ,peshën e veprës penale ,kështu që me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntë dhjet) ditëve ,i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej 1(një) viti, të mos kryejnë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi dhe efekti i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien ne barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri ne mbështetje te nenit 453/4 te KPP-ës ,pasi qe i akuzuari është shfrytëzues i ndihmave sociale e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do te rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarit ose të personave që ai detyrohet ti mbështes materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 77/18 datë 30.08.2018.**

**Sekretarja juridike,
Bute Ramosaj**

**Gj y q t a r j a,
Ilijana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.